

# **PERMBLEDHJE JOTEKNIKE**

**SUBJEKTI: EURO TANK SH.A**

**NIPT: L822265505A**

**ADMINISTRATORI: Asllan Kuqi**

## PERMBAJTJA

1- HYRJE

2- Informacion mbi shoqerine

3- Pershkrimi i projektit dhe veprimtarise

4- Pershkrimi teknik i projektit

5- Masat zbutese te ndikimeve negative

6- Konkluzione dhe rekomandime

## 1. HYRJE

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i Burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje, toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje problem mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Sebashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara, emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme. Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne. Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithë. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

### **Pasqyra e te dhënave kryesore**

**Projekti:** Ndertim dhe shfrytezim i depozitave bregdetare shtese per nafte bruto dhe nenprodukteve te saj.

**Me vendndodhje:** Durrës, Zona Kadastrale 3184, nr. pasurie 68/15, Porto Romano.

**Kompania zhvilluese:** “Euro Tank” Sh.a

Kapaciteti total i shtesave te kapaciteteve depozituese eshte: 81802 m<sup>3</sup>.

## 2-INFORMACION MBI SHOQERINE

Subjekti **EURO TANK, SH.A** eshte e regjistruar ne organet tatimore me nr identifikimi NIPT **L82226505A** me vendndodhje **Durrës, Zona Kadastrale 3184, nr. pasurie 68/15, Porto Romano.**

Subjekti **EURO TANK, SH.A** do te aplikojte per leje mjedisore te tipit B. Subjekti duke zhvilluar aktivitetin, do te beje te mundur nje menaxhim sa me te mire te burimeve natyrore.

### 3-PERSHKRIMI I PROJEKTIT DHE VEPRIMTARISE

#### Qellimi i zhvillimit te projektit

Veprimtaria qe do zhvilloje ky subjekt eshte:

**Industritë Energjitikë.**

#### **I.D 1.9 Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj:**

**a. Magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisterna të palëvizshme në ndonjë terminal, ose ngarkim/shkarkim i naftës dhe nënprodukteve të saj, në/nga një cisternë e levizshme, cisternë hekurudhore, ose anije e ujërave të brëndshme në terminal;**

Te gjitha proceset e punes, do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

### 4. PERSHKRIMI TEKNIK PROJEKTIT

Qellimi i ketij investimi eshte:

- Rritja e kapacitetit te pritjes se produkteve te naftes qe vijne ne rruge tokesore me autocisterna dhe ate detare me anije te tipit cistern.
- Ruajtja e tyre ne rezervuaret perkates
- Mbushja e autocisternave dhe shperndarja e tyre ne destinacion

Objekti “Impianti shtese i depozitimit te karburanteve” i shoqerise “EURO TANK” sh.a eshte i destinuar per pritjen e produkteve te naftes, qe vijn ne rruge tokesore me autocisterna dhe ate detare me anije te tipit cisterna, ruajtjen e tyre ne rezervuaret perkates, mbushjen e autocisternave si dhe shperndarja e tyre ne destinacion.

Ky objekt ngrihet ne zonen e Porto Romanos, komuna Katundi i Ri - Durres. Ajo ndodhet ne veriperendim te qytetit te Durresit ne nje distance rreth 6 kilometra ne vije

Zona ku do te ndertohen keta rezervuare ka nr kadastral 3184 me nr. pasurie 68/15. Ne kete zone ndodhet zyra administrative, blloku i pompave, tenda, vendi ngarkimit, tenda e mitingut, depozita dekantimit, 3 rezervuar cilindrik, rezervuar uji, nje rezervuar bitum gazi dhe nje rezervuar karburanti.



**Fig. Skema e vendndosjes se zones se objektit**

Kapaciteti depozitues total i objektit prej reth 35.000 m<sup>3</sup> eshte i realizuar nga parku me 2 rezervuare metalike cilindrike, vertikal, mbitokesore. I gjithe parku I rezervuareve sistemohet ne nje argjinate te rrethuar me mure betoni te armuar me lartesi reth 2.4m. Ne kete argjinate jane vendosur dy rezervuare me volum gjeometrk secili prej rreth 17 500 m<sup>3</sup>.

#### Dimensionet

Dimensionet e rezervuarit (46802 m<sup>3</sup>) jane, diametri 66.21 m, lartesia 16 m dhe kapaciteti 46802 m<sup>3</sup>. Ndersa ato te rezervuareve 17500 m<sup>3</sup> jane, diametri 37.56 m, lartesia 18.6 m dhe kapaciteti 17500 m<sup>3</sup>.

Pjeset perberese te rezervuareve jane:

- Bazamenti
- Dyshemeja
- Muri
- Catia
- Bokaportat
- Sistemi i drenazhimit te catise
- Shkalle ekoloidale
- Prites shkume ne cati
- Ventilimi automatic dhe ventilimi anesor
- Sistemi ftohjes me uje
- Sistemi shkumes he prites shkume siper
- Shirt tokezimi per catine
- Tokezimi murit te RVM
- Bokaportat e trupit

- Hyrjet dhe daljet e trupit
- Serpentinat
- Gominat
- Veshja e rezervuareve

### **Veshja e rezervuareve**

Siperfaqet e jashtme te rezervuareve si muri, catia, hyrjet dhe daljet, shkallet, platforma Siperfaqet e jashtme te rezervuareve si muri, catia, hyrjet dhe daljet, shkallet, platforma dhe aksesoret e jashtem do te pastrohen me rere SA ½(ISO8501/1). Me pas ata do te vishin me primer dhe do aplikohet nje shtrese veshje me zink EPOXY minimumi 50 Micron. Ne fund behet veshja e RVM me shkume 60+35.

Kapaciteti depozitues total i objekteve shtese prej rreth 81802 m<sup>3</sup> eshte i realizuar nga 3 rezervuare metalik, cilindrik, vertical, mbitokesore. Te tre rezervuaret do te sistemohen ne dy argjinatura te vecanta, te ndara sipas llojit te nenproduktit te naftes te depozituar dhe te rrethuar me mure betony te armuar me lartesi rreth 2 m.

Ne njeren argjinature do te vendoset nje rezervuar me volum gjeometrik 46802 m<sup>3</sup>, ndersa ne argjinaturen tjeter jane vendosur dy rezervuare me volum gjeometrik 2x17500 m<sup>3</sup>.

Rezervuaret shtese te kesaj shogerie do te ndertohen brenda kufijve te impiantit te depozitave te naftes te shogerise EURO PETROL sha me nje siperfaqe prej 31983 m<sup>2</sup> me destinacion per nafte bruto dhe nenprodukte te saj, me nje kapacitet total prej 81802 m<sup>3</sup>.

Sikurse duket dhe ne skemen teknologjike qe shoqeron kete projekt plani i organizimit te ketij sheshi ndertimi perbehet nga dy element kryesor

- Impianti i depozitave
- Sistemi i pompave dhe linjave per furnizimin e depozitave

Impianti i depozitave bregdetare do te jete i destinuar per perpunimin e karburanteve, kryesisht nafte bruto dhe nenprodukteve te saj.

### **Tubacionet e linjes teknologjike**

Skema e shtrirjes se tubacioneve te linjave teknologjike parashikon realizimin e operacioneve te radhes:

- Marrjen e produkteve te naftes si benzines dhe gazoil, qe vjen me anije te tipit cisterno ne pontilin bregdetar dhe dergimin e tyre me stacion pompimi ne parkun e rezervuareve cilindrik vertikal.
- Marrja e produkteve te naftes si benzines dhe gazoil, me stacion pompimi nga rezervuaret cilindrik vertikal per ne estakaden e ngarkimit te autocisternave.

Na skema e linjave te tubacioneve teknologjike, parashikohet perputhja ne kohe e operacioneve ne marrjen e te gjithë llojeve te produkteve te naftes dhe dergimit te tyre ne rezervuaret perkates si dhe ate te dergimit te tyre nga rezervuaret ne estakaden e ngarkimit te autocisternave.

Montimi i tubacioneve te linjave teknologjike, eshte parashikuar kryesisht te behet mbitokesor, me perjashtim ku per arsye teknologjike e konstruktive jane te detyruar ti kalojme nentokesore. Gjithashtu tubacionet e perdorur jane klasifikuar per regjim konstant shfrytezimi, me parete te pandryshueshme, me regjim izotermik shfrytezimi dhe per presion 10 MPA.

Diametrat e tubacioneve te linjave teknologjike jane percaktuar me metoden e llogaritjeve hidraulike, duke pranuar shpejtesite e rrjedhjes se lengut ne tubacionet e dergimit 2-3 m/sek, ndersa ne tubacionet e thithjes 0.8-2m/sek.

Makinerite dhe pajisjet kryesore te objektit "Terminali i depozitimit te karburanteve" jane zgjedhur bazar ne te dhenat fillestare te produktit qe trajtohen (vetite fiziko-kimike te tyre), kapacitet perpunues 400 m<sup>3</sup>/h dhe atij depozitues 81802 m<sup>3</sup>. Rezervuaret e vendosur ne kete objekt, mbeshtetur ne skemen teknologjike te zejedhur si dhe ne kerkesat e tregut sigurojne nje kapacitet maksimal te bazes prej rreth dy jave.

Te gjitha makinerite si, stacion pompimi, sistemi i mbrojtjes nga zjarri, uji MNZ, etj. do te perdoren ato egzistuese ne terminalin egzistues.

## 5-MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

### Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate procesit te magazinimit te naftes, si te pluhurit ne ajer, zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor, faune dhe flore.

#### ➤ Parandalim

- Perzgjedhja e teknologjise me cikël te mbyllur me pajtueshmeri mjedisore.
- Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar.
- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit.
- Siperfaqja e terminalit do te jete vazhdimisht e lagur per shmangien e ngritjes se pluhurit gjate aktivitetit.
- Kontroll i vazhdueshem dhe mirembajtje e filtrave te kapjes se pluhurit dhe gazeve.
- Sigurimi i sistemit te komandimit te pompave, filtrave dhe pastruesve te tjere.
- Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj.
- Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjithë teknologjise se projektit, sistem i qarkullimit te produktit, saracineska, tubo, valvola, tapa, guarnicione.

#### ➤ Kontroll

- Sigurimi i te gjitha pajisjeve te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash.
- Sperkatje e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve ne terminal.
- Levizje e ngadalte e automjeteve ne terminal dhe jashte tij.
- Mirembajtja e makinerive dhe kamioneve te punes.
- Transporti i inerteve me kamion te mbuluar mbulese me Polietilieni.
- Gjeneratori duhet te rrethohet me mur dhe te kete nje vend te vecante.

- Perreth skelave te ndertimit te vendosen rrjeta te cilat duhet te bejne mbulimin e gjithë lartesisë së ndertimit me qëllim që të reduktohet përhapja e pluhurave. Njekohesisht kjo masë ndikon në parandalimin e incidenteve.

#### ➤ **Nderhyrje**

- Riparim i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike.
- Aktivizim i menjehershëm i stafit dhe mjeteve në rast emetimesh dhe derdhjesh të pa parashikuara sipas skemes.
- Pastrim i menjehershëm i derdhjeve aksidentale
- Njoftim i menjehershëm i autoriteteve dhe njesive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, autoambulanca)

#### ➤ **Administrim**

- Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi e të gjithë infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.

#### ● **Pluhura të shkaktuara gjatë fazës së transportit (aerosole)**

- Mjetet e transportit duhet të levizën të mbuluara gjatë transportit të inerteve, për të shmangur përhapjen e dheut në rrugë ose të pluhurave.
- Mjetet duhet të pastrohen vazhdimisht para daljes së tyre nga terminali.

#### ● **Emetim gazesh nga automjetet për transport të lëndës së parë**

- Sasia do të jetë minimale por duhet të punohet me efikasitet dhe të ulët koha e mbajtjes ndëzuar pa qenë nevoja e motoreve të mjeteve.
- Automjetet që do të përdoren të jenë në gjendje të mirë mekanike me qëllim që të mos shkaktojnë emetime të tepërta të gazeve në atmosferë.

#### ● **Emetim zhurmash vibracioni dhe aromash**

- Duhet të kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet për zhurmen e shkaktuar. Edhe për këtë ndikim duhet të shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndëzuar të motorave të mjeteve.
- Objekti është me funksion depozitimi dhe nuk do të zhvillohen aktivitete që kanë zhurmë në mjedis.

#### ● **Menaxhimi i mbetjeve ngurta**

- Administrata dhe punonjësit e terminalit do t'i kushtojnë vëmendje të vecantë edhe këtij aspekti për të parandaluar ndotjen në mjedis. Në mjediset e terminalit janë vendosur kosha të grumbullimit të mbetjeve të krijuara nga konsumi i përditshëm i punonjësve në objekt, që do të jenë të formave plastike, material letre, mbetje organike etj. Mbetjet urbane duhet të menxhohen dhe diferencohen në burim dhe të depozitohen në venddepozitim të caktuar nga NJ.Q.V-ja.

#### ● **Programi i monitorimit dhe elementet e tij**

- Në përgatitjen e programit të monitorimit, specialistët kanë marrë në konsideratë mundësinë për të realizuar një monitorim realist të elementeve me ndikim në mjedis.



Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te identifikohen, maten, regjistohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (AKM, etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne Agjensine Kombetare te Mjedisit sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve ne fuqi.

## 6-KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### Perfundime

- Zbatimi i projektit nuk do te kete pasoja negative te mundshme ne mjedisin e zones.
- Ne terminal nuk do te kete impiante me djegie dhe nuk do te kete shkarkime te gazeve te demshem per mjedisin. Emetimet ne ajer do te vijne vetem nga levizja e mjeteve ne sheshin e terminalit dhe nga perdorimi i gjeneratorit ne rast te nderprerjes se energjise elektrike.
- Drejtuesit e shoqerise do te marrin masa per sperkatjen me uje, për pajisjen e punëtoveve dhe manovratoreve te mjeteve te renda me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, kapele mbrojtese, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.
- Niveli i zhurmave qe vijne nga automjetet dhe pajisjet e tjera jane brenda normave te lejuara. Nuk perbejne problem shqetesues per punonjesit dhe as per banoret e zones perreth qe jane ne nje distance te konsiderueshme.
- Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga kabina dhe paneli i komandimit ne terminalin ekzistues.
- Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore, pra nuk kemi ndryshime apo demtime te saj duke qene se nuk ekziton ne kete territor. Kjo zone perfshihet brenda nje propozimi te UNEP, si zone e propozuar per kalimin ne statusin zone e mbrojtur.
- Per nje pune sa me optimale në terminal zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punetoret e manovraret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesit teknik te terminalit.

### Rekomandime

Duke ditur se gjate proceseve te punes ne linje emetohet në mjedis pluhur i lehte, ka zhurma te makinerive, për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis, duhet:

- Te behet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike te automjeteve
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis.
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te pluhurit ne ajer.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik,
- Te mirembahen kanalet e drenazhimit te ujerave perreth perimetrit te

aktivitetit

- Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore.
- Te sigurohet furnizim i mire me energji elektrike per te reduktuar ose shmangur oret e punes se gjeneratorit dhe nderprejre te procesit te punes.
- Te perdoret lende djegese e cilesise se pare per gjeneratorin dhe mjetet e transportit.
- Te aplikohet sperkatja me uje e shesheve te pa shtruara per te reduktuar pluhurin.
- Te kryhet mirembajtja e automjeteve te transportit ne menyre periodike.
- Te vendosen kosha dhe postera sensibilizues per mbajtjen paster te ambjenteve.
- Investitori te respektoje detyrimet e vena ne Lejen Mjedisore qe do te miratohet nga Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
- Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe ndryshimeve te tij.
- Te kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve ne fuqi dhe te dergohet nje relacion shkresor cdo 6 muaj prane Agjencise Kombetare te Mjedisit. Te respektohen normat e teknikes se sigurimit ne pune nga punetoret